



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË - OPŠTINA VUÇITRN	
01 Nr. / Br	143/18
Nr. i fq. / Br. st	- 15 -
Data: / Datum	31. 05. 2018
VUSHTRRI - VUÇITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL
NGA MBLEDHJA E -IV- E RREGULLT E KUVENDIT TË KOMUNËS SË
VUSHTRRISË, MBAJTUR MË 26 PRILL 2018

Mbledhja është mbajtur në sallën e Kuvendit Komunal, duke filluar në orën 10:15.

Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtri: Abdullah Vojvoda, Agim Bregaj, Agron Perçuku, Ali Januzi, Arta Ymeri, Bahrije Ademi Murati, Ermal Lahu, Fakete Dushi, Fatmire Saraçi, Faton Shabani, Fjolla Ujkani, Gentiana Rama, Gresa Muli, Habibe Gërxhaliu, Hysni Gërguri, Ilmi Azemi, Kushtrim Hyseni, Lorik Maxhuni, Lutfi Bilalli, Mehdi Bejtullahu, Mejreme Ismajli, Melihate Basholli-Latifi, Miljan Bojković, Nasuf Aliu, Nezir Klinaku, Qerim Selimi, Rrezarta Krasniqi, Sadije Bajgora, Safet Idrizi, Sami Istrefi, Shkëlzen Feka, Shpëtim Zhegrova, Teuta Aruçi Shartari dhe Ymer Haradinaj.

Mungoi: Basri Menxhiqi

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës - z.Xhafer Tahiri, nënkryetari i komunës – z.Besim Muzaqi, përfaqësues të delegacionit nga Komuna Växjö- e Suedisë, përfaqësuesi i KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, përfaqësues të mediave të shkruara dhe elektronike, përfaqësues të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Nasuf Aliu – kryesues i kuvendit, i cili konstatoi se ka shumicë për punë dhe për marrje të vendimeve të plotfuqishme, andaj procedoi me rendin e ditës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – pasi përshëndeti gjithë të pranishmit në emër të grupit kuvendar të PDK-së deklaroi se e përkrahin rendin e ditës me pika shtesë që janë propozuar në pikën në të ndryshme.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se si Lëvizje për Bashkim pajtohen me rendin e ditës i cili është propozuar, dhe shtoi se duhet të respektohet Plani i Punës së Kuvendit, sa i përket pikave që duhet të shqyrtohen dhe aprovohen nga ana e kuvendit, duke aluduar në draft-rregulloren për ndryshimin e Rregullores për Organizimin e Fshatrave dhe Lagjeve Urbane, e cila është planifikuar që të shqyrtohet në muajin prill dhe e njëjta nuk është dërguar nga ana e drejtorisë.

Mehamet Selaci, drejtor i Drejtorisë së Administratës - njoftoi se arsyetimi për mosdërgimin e kësaj pike, është përcjellë në Sekretarin e Kuvendit, për nuk e di arsyen se përse ajo nuk iu është dërguar anëtarëve të kuvendit, për këtë njoftoi se kjo pikë do të procedohet në kuvend gjatë muajit maj.

Në fund të diskutimeve lidhur me rendin e ditës kuvendi në mënyrë “unanime” aprovoi këtë:

RENDITE

1. Fjalimi i kryesuesit të delegacionit suedez z.Benny Johanson;
2. Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 29.03.2018;
3. Shqyrtimi i Raportit tremujor janar-mars 2018 mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore;
4. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrisë për periudhën 2019-2022;
6. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për prona të paluajtshme;
7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrisë;
8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore;
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2017;
10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit për vitin 2017;
11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2017;
12. Të ndryshme.
 - a). Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen e z. Tom Phillips “Qytetar nderi” i Komunës së Vushtrisë;
 - b). Shqyrtimi i Draft-marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet qytetit Norwalk (Iowa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe qytetit të Vushtrisë (Republika e Kosovës);
 - c). Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtim të shtëpisë për Valon Malokun;
 - ç). Shqyrtimi i Propozim - vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtim të shtëpisë për Hamdi Hajdarin;
 - d). Njoftimi i kryetarit të komunës lidhur me licencimin e zonës ekonomike në fshatin Lumadh;
 - dh). Shqyrtimi i Propozim – vendimit lidhur me procedurat e funksionalizimit të Zonës ekonomike në fshatin Lumadh dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë;
 - e). Shqyrtimi i raportit lidhur me implementimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrisë.

1.Fjalimi i kryesuesit të delegacionit suedez z.Benny Johanson

Benny Johanson, kryesues i delegacionit nga Komuna Växjö- e Suedisë - paraqiti disa informata lidhur me Komunën e Växjö, si dhe foli lidhur me zhvillimin e bashkëpunimit mes dy komunave respektive.

2.Shqyrtimi dhe aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e rregullt e kuvendit të komunës, i datës 29.03.2018

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi procesverbalin nga mbledhja e rregullt e kuvendit, e datës 25.01.2018, me vërejtjet e paraqitura nga anëtarja e kuvendit.

3. Shqyrtimi i Raportit tremujor janar-mars 2018 mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se Drejtoria e Administratës si dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa, ka shënuar rezultatet pozitive në realizimin e të hyrave, të cilat afërsisht janë në gjendjen e njëjtë me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar. Sa i përket Drejtorisë së Shërbimeve Publike, dihet fakti se akoma nuk ka filluar inkasimi i të hyrave nga taksat për mbeturina dhe këtu nuk kanë mundur të grumbullohen të hyra, pastaj ceku se është fakti interesant se nga parkingjet kemi inkasuar vetëm 25 €. Mandej bujqësia dhe shëndetësia nuk janë keq lidhur me inkasimin. Tutje u ndal tek Drejtoria e Urbanizimi ku ceku se gjatë fushatës ka pasur pompozitet dhe krekosje të madhe se nga kjo lëmi do të gjenerohen shumë të hyra, sidomos nga lejet ndërtimore, por e vërteta është se kjo qeverisje aktuale nuk ka mundur të gjenerojë të hyra më shumë se qeveria e kaluar për të njëjtën periudhë. Tek përmbledhja e këtij raporti vlerësoi se shpresoi se kemi të bëjmë me një gabim teknik dhe që kjo nuk është bërë me qëllim, ku ceket se të hyrat komunale për periudhën e njëjtë krahasuar me vitin 2017 të hyrat vetanake janë më të mëdha për 62,983.000 € e që shprehur në përqindje i bie se të hyrat janë më të mëdha për 120 % dhe kjo dihet që është gabim, por ai shpreson që kjo të mos është bërë me qëllim. Nëse i referohemi gjithë shifrave dhe përqindjeve, atëherë del se shpenzimet për udhëtime zyrtare për këta tre muaj, krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit të kaluar janë më të mëdha për 3200 %, mandej shpenzimet e telefonisë mobile 204 %. Pastaj lidhur me shpenzimet e karburanteve për automjetet zyrtare, vlerësoi se me dhjetëra herë është thënë se automjetet e komunës janë të stërvjetruara dhe kanë shpenzime enorme, dhe heqja nga përdorimi i këtyre automjeteve ishte premtim elektorale i kryetarit të komunës. Në fushatën paraelektorale gjithashtu ishte premtuar se gjatë një viti do të punësohen 300 punëtorë në Komunën e Vushtrrisë, gjë që ky premtim ishte gjoja tunduese për qytetarët e Vushtrrisë. Këtë premtim e kishte bërë kryetari aktual i komunës dhe kur ishte pyetur nga gazetarët se nga do t'i marrë paratë për punësimin e këtyre 300 punëtorëve, ai decidivisht kishte deklaruar se vetëm nga kursimi i parave për karburantet e automjeteve do të paguheshin këta 300 punëtorë, por kjo jo që nuk është realizuar, por që fatkeqësia është edhe më e madhe pasi që shpenzimet për karburante për periudhën tremujore të kësaj qeverie janë më të mëdha sesa ato të qeverisë së kaluar krahasuar me periudhën e njëjtë raportuese. Në fund deklaroi se si LB nuk do ta votojnë këtë raport.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se ky raport tremujor nuk është i plotë pasi që në shumë raste mungojnë arsyetimet dhe shpjegimet sidomos tek shpenzimet, ndërsa sa i përket inkasimit të të hyrave vetanake për këtë tremujor është evidente se ato janë realizuar vetëm në masën prej 65% dhe kjo në fakt tregon nivelin e performancës të kësaj qeverie e cila nuk i ka përmbushur planifikimet buxhetore dhe ka inkasuar më pak mjete në shumën prej 200.000 €. Pastaj tek sqarimet në fund të tabelës ku përshkruhen të hyrat vetanake sipas drejtorive dhe kodeve ekonomike obligimet në emër të taksës në firmë 490.596.051 €, por ky grumbullim i këtyre mjeteve është bërë si rezultat se shumë biznese janë regjistruar, por nuk kanë zhvilluar veprimtari ekonomike po që janë ngarkuar me taksë komunale. Tutje shtoi se me rregullore është vendosur që në bashkëpunim me Administratën tatimore të bëhet e mundur që ato biznese që nuk kanë zhvilluar aktivitet ekonomik t'ju fshihen obligimet apo t'u hiqen obligimet e taksës komunale. Tek tabela përmbledhëse e shpenzimeve sipas drejtorive për periudhën *janar-mars* 2018 tek kodi ekonomik 160 zyra e kryetarit, pozicioni shpenzimet nuk korrespondojnë me prononcimet javore të kryetarit dhe këtu duhet të ndërrohet kjo qasje e këtyre prononcimeve për faktin se po vihen në lajthitje qytetarët, por edhe anëtarët e kuvendit, andaj lidhur me këtë kërkoi nga drejtoria gjegjëse që të bëjë definimin e qartë të kategorisë së shpenzimeve të zyrës së kryetarit dhe jo me këtë të bëhet marketing politik. Mandej ceku se për këtë periudhë raportuese zyra e kryetarit ka shpenzuar 48,696.015 € e që kjo ka një dallim të madh me raportet javore të kryetarit të komunës (apo ndoshta aty po raportohen shpenzimet e kryetarit për çaj dhe kafe). Tek shpenzimet mallra, shërbime dhe subvencione, kodi ekonomik 13130

pozicioni shpenzime zyrtare brenda vendit në vlerën prej 300 €, kjo është shqetësuese sepse në të kaluarën kjo nuk ka ndodhur dhe tregon një shenjë jo të mirë të qeverisjes. Pastaj tek kodi ekonomik 13141 mëditje për udhëtime zyrtare jashtë vendit, për këtë periudhë raportuese janë shpenzuar 2743 €, kurse vitin e kaluar për të njëjtën kategori dhe për të njëjtën periudhë raportuese janë shpenzuar vetëm 83 €. Lidhur me këtë çështje vlerësoi se duhet të aprovohet një rregullore e cila do rregullonte çështjet e mbulimit të shpenzimeve të mëditjeve për udhëtimet jashtë vendit. Mandej tek kodi ekonomi 13320 shpenzimet e telefonisë mobile janë në vlerën prej 3800 €, kodi ekonomik 13250 shpenzimet e telefonisë fikse 4167 € këtu edhe përkundër se kemi bartje të disa shpenzimeve prapë konsideron se këto shpenzime janë shumë të larta dhe këtu mund të kemi kursime. Pastaj tek investimet kapitale duhet cekur se qeveria ka zero investime edhe pse është raportuar një shumë afro 50.000 €, por këtë duhet sqaruar pasi që këtu kemi të bëjmë me obligime të bartura më herët. Tutje ceku se është me rëndësi të sqarohet dhe kjo adresohet edhe si pyetje furnizime për pastrim kemi një vlerë prej 93 € për tre muaj dhe në këtë bëjnë pjesë 51 shkolla dhe më këtë vlerë të mjeteve qeveria ka “arritur” të mirëmbajë gjendjen sanitare dhe higjienike të këtyre institucioneve. Kjo gjendje ka degjeneruar deri në atë pikë sa që nuk kemi letër sanitare dhe shampon për pastrimin e duarve në WC dhe banjot e komunës, andaj për këtë duhet të veprojnë inspektorati sanitar, pasi që duhet të konstatohet gjendje se a mos kemi nevojë për dezinfektim, dezinfektim apo deratizim të këtyre objekteve. Në këtë kontekst vlerësoi se kemi të bëjmë me një gjendje alarmante ku duhet të ndërmerren masa urgjente.

Lutfi Gërgurri, drejtor i DBF-së - paraqiti sqarime lidhur me raportin tremujor janar-mars 2018 mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore, si dhe dha përgjigje në temat e shtruara nga anëtarët e kuvendit.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se gjatë hartimit të raporteve sidomos atyre financiare duhet të jemi të kujdesshëm që mos të lëshohen gabime ashtu që gjendja të pasqyrohet në mënyrë jo të saktë.

Sedat Rashica, drejtor i DSHP - paraqiti sqarime lidhur me inkasimin e mjeteve financiare nga parkingjet e komunës.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, kuvendi pas votimit me 19 vota “për” 2 vota “kundër” të tjerat “abstenim” aprovoi raportin tremujor janar-mars 2018 mbi të hyrat dhe shpenzimet buxhetore.

4.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për lejimin e ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në parcelat kadastrale si në vijim:

1.1 Në parcelën kadastrale me Nr.P-70215006-00370-0 me kulturë arë e klasës së pestë (5), Zona kadastrale Beçiq, me sipërfaqe të përgjithshme prej 11.595m² nga e cila bëhet shndërrim në tokë ndërtimore në sipërfaqe prej 259 m², pronë e Enver Ismajlit me ½ të pjesës së ngastrës kadastrale dhe Ndriçim Ismajlit pronar i ½ të pjesës së ngastrës të cekur më lart.

1.2. Në parcelën kadastrale me Nr.P-70215006-00368-0 me kulturë arë e klasës së 4 (katër) me sipërfaqe të përgjithshme 28715 m² nga e cila bëhet shndërrimi në tokë ndërtimore në sipërfaqes prej 79.29 m² dhe parcelën kadastrale me Nr.P-

70215006-00369-0 me kulturë arë e klasës së tretë me sipërfaqe të përgjithshme 1354m² nga e cila bëhet shndërrimi i sipërfaqes prej 15.54m², Zona Kadastrale Beçiq, Komuna e Vushtrrisë, pronë e z.Enver (Vesel) Ismajlit.

2. Qëllimi i lejimit të ndërrimit të destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore në vendin e quajtur „Bubina ner shpi” në parcelën kadastrale të cekur si në pikën një (1) të këtij vendimi është ndërtimi i objektit „Dhomë për prodhimin, përpunimin dhe promovimin e mjaltit”.

3. Lejen ndërtimore dhe kushtet për rregullimin e hapësirës për ndërtimin e objektit nga pika e dytë do ta lëshojë dhe përcaktojë konform dispozitave ligjore Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pas pagesës së tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore.

4. Obligohet pronari i parcelës nga pika 1 e këtij vendimi që të bëjë pagesën e tarifës për ndërrim të destinimit të tokës bujqësore sipas nenit 14.2 në „b” të Udhëzimit administrativ për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore Nr. 41/2006 përmes Drejtorisë për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë: certifikatat e pronësisë, kopja e planit, pëlqimi i dhënë nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

6. Për zbatimin e këtij vendimi obligohet Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, si dhe Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

5. Shqyrtimi i Propozim-vendimit për hartimin e Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2019-2022

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se ekziston Plani Zhvillimor Komunal, i cili është në fuqi, dhe kërkoi që për këtë çështje të jepen sqarimet e nevojshme para se të merret një vendim.

Idriz Muzaqi, Udhëheqës i Zyrës Ligjore - duke iu referuar parafolësit njoftoi se Plani Zhvillimor Komunal është një plan gjeneral, ndërsa këtu po bëhet fjalë për Strategjinë e Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrrisë, i cili është vetëm një segment i zhvillimit të qytetit të Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim lejohet hartimi i Strategjisë së Zhvillimit Ekonomik të Komunës së Vushtrrisë për periudhën 2019 - 2022.

2. Autorizohet Kryetari i komunës, përkatësisht qeveria komunale që të ndërmarrin veprimet e nevojshme për hartim të këtij dokumenti strategjik për komunën, duke siguruar respektimin e të gjitha procedurave të parapara ligjore në të gjitha fazat e hartimit, deri në miratim në kuvendin e komunës.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

6.Shqyrtimi i Propozim-vendimit për caktimin e interesit të përgjithshëm për prona të paluajtshme

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – tha se parimisht e përkrahin këtë propozim-vendim dhe shtoi se kishte me qenë mirë që drejtoria kompetente të japë një sqarim lidhur me pozicionin e këtyre pronave.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – pasi e përgëzoi drejtorinë kompetente për hartimin e këtij propozim-vendimi me pjesët shtesë për siç tha ai në mënyrë tejet profesionale, shtoi se është mirë që kuvendi të shpallë sa më shumë zona me interes, pasi që komuna ka nevojë për prona.

Adnan Lahu, drejtor i DGJKP-së - paraqiti sqarime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës si dhe u përgjigj në pyetjet e anëtarëve të kuvendit.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim caktohet interesi i përgjithshëm për ndërtimin e infrastrukturës shkollore, shëndetësore, kulturore dhe projekte tjera me interes për Komunën e Vushtrrisë në Zonën Kadastrale Vushtrri, në pronat e paluajtshme si vijon:

1.1 Parcela kadastrale P-70202016-01431-0 me sipërfaqe prej 16747m², P-70202016-02231-0 me sipërfaqe prej 15990m², P-70202016-02253-5 me sipërfaqe prej 3633m², ZK Vushtrri, evidentuar në emër të PSH Kooperativa Bujqësore Vushtrri.

1.2 Parcela kadastrale nr.4103-1 me sipërfaqe prej 5696m² dhe parcela kadastrale nr.4104-1 me sipërfaqe prej 21826m², fletëtreguesi i gjendjes faktike në komasacion nr.600, ZK Vushtrri, evidentuar në emër të Kooperativës Bujqësore Vushtrri.

2. Paluajtshmëria e cekur në pikën 1 të këtij vendimi shërben për caktimin e lokacionit për ndërtimin e objekteve shkollore, shëndetësore, kulturore dhe projekte tjera me interes për Komunën e Vushtrrisë.

3. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë, Drejtoria për Arsim, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, si dhe Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë certifikatat e pronës dhe ortofotot.

5. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

7. Shqyrtimi i Informatës lidhur me ndërtimet në Komunën e Vushtrrisë

8. Shqyrtimi i Informatës tremujore për sigurinë ushqimore

Agim Bregaj, anëtar i kuvendit – tha se çështja e sigurisë ushqimore është jetike për shëndetin e qytetarëve tanë, andaj kërkoi nga organet kompetente që të shtojnë masat e sigurisë ushqimore përmes vizitave të vazhdueshme në terren të inspektorëve sanitar. Gjithashtu ai vlerësoi se duhet kushtuar kujdes të veçantë ushqimeve që servohen në lokalet e ndryshme, dhe atyre të ambalazuara, të cilat janë burim i sëmundjeve alimtare. Në fund kërkoi mobilizim të përgjithshëm të të gjithë akterëve në ngritjen e sigurisë ushqimore dhe sigurimin e shëndetit të qytetarit tanë.

Ermal Lahu, anëtar i kuvendit – tha se informata për sigurinë ushqimore është mjaft e mirëseardhur për shkak të shqetësimit të para disa muajve lidhur me mishin me afat të skaduar i cili ka ardhur në vendin tonë. Tutje shtoi se konsumatorët tanë thuajse çdo ditë po hasin në probleme qoftë të cilësisë së produkteve, qoftë në afatin e skaduar të tyre. Pastaj shtoi se ka raste kur afati i produktit të ripërpunohet dhe pakënaqësitë e konsumatorit në këtë pikë janë prezent. Andaj për këtë inspektorati i tregut dhe ai sanitar duhet të ketë intensitet më të lartë të punës në mënyrë që të ruhet shëndeti i konsumatorëve. Nga statistikat e dhëna në informatë del se kemi gjithsej tri ankesa të qytetarëve ku dy prej tyre kanë rezultuar të pabazuara, kurse njëra ka rezultuar e bazuar, kjo tregon shumë pak, për faktin se rastet në teren janë shumë më të mëdha. Në fund apeloi tek të gjithë qytetarët e Vushtrrisë që të gjitha parregullsitë lidhur me produktet t'i denoncojnë tek organet kompetente, si dhe kërkoi që të kemi shtim të aktivitetit në kontrollimin e produkteve nga ana e inspektorëve sanitarë.

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit – tha se në raportin e dorëzuar lidhur me asgjësimin e produkteve thuhet se janë asgjësuar sasi të produkteve ushqimore me afat të skaduar, mirëpo nuk thuhet se janë shqiptuar gjoha konform ligjit si masë preventive. Andaj në këtë rast nuk është e efektshme që të merremi vetëm me pasojat, duke i asgjësuar produktet, por duhet të merremi edhe me shqiptimin e masave preventive. Në vazhdim ajo duke iu referuar Ligjit për Inspektoratin Sanitar të Kosovës, kërkoi që të kemi shtim të numrit të inspektorëve sanitarë me qëllim që të rritet siguria ushqimore e qytetarëve, dhe kjo të bëhet konform numrit të popullatës në komunën tonë, si dhe duke u bazuar në faktin se kemi mjaft studentë që kanë përfunduar drejtimin adekuat për këtë profesion.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2017.

Pas shqyrtimit të kësaj pike, kuvendi me vota unanime aprovoi Raportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale për vitin 2017.

10. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit për vitin 2017.

Pas shqyrtimit të kësaj pike, kuvendi me vota unanime aprovoi Raportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Urbanizëm dhe Mbrojtjen e Ambientit për vitin 2017.

11. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2017

Pas shqyrtimit të kësaj pike, kuvendi me vota unanime aprovoi Raportin vjetor të Komitetit Konsultativ për Persona me Nevoja të Veçanta për vitin 2017.

12. Të ndryshme.

a). Shqyrtimi i propozim-vendimit për shpalljen e z. Tom Phillips “Qytetar nderi” i Komunës së Vushtrrisë

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – tha se shpallja e z.Tom Phillips “Qytetar nderi” i Komunës së Vushtrrisë, është një nder që i bëjmë atij dhe qytetit të Norwalk, por nder i bëjmë edhe vetes sonë, andaj kërkoi që ky propozim të mbështetet unanimisht nga kuvendi dhe kjo të bëhet një standard që më të gjitha komunat me të cilat binjakëzohet Komuna e Vushtrrisë, kryetarët e tyre të shpallen qytetarë nderi. Tutje ai njoftoi se ceremonia për shpalljen qytetar nderi, do të mbahet më datë 10 maj dhe ajo do të jetë madhështore, ku anëtarët e kuvendit do të jenë të pranishëm, por aty do të jenë të ftuar personalitete nga institucionet relevante të Republikës së Kosovës. Pastaj ai njoftoi kuvendin se lidhja e marrëveshjes së binjakëzimit me qytetin Norwalk të Iowa është mjaft me interes për qytetin tonë ku do të ketë shkëmbim përvojash në lëmin e bujqësisë, pastaj në lëmin e arsimit do të mundësohet binjakëzimi i një shkollë me një shkollë të qytetit Norwalk - Iowa, ku është vendosur që ajo shkollë të jetë shkolla profesionale “Bahri Haxha”, por do të ketë edhe përfitime në lëmin e zhvillimit ekonomik. Në fund ai kërkoi që të përkrahet propozimi për shpalljen z.Tom Phillips “Qytetar nderi” i Komunës së Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim z. Tom Phillips, kryetar i qytetit Norwalk të shtetit Iowa - SHBA, shpallet “Qytetar nderi” i Komunës së Vushtrrisë.

2. Në ditën e vizitës në Komunën e Vushtrrisë, më 9 maj 2018, të përmendurit i dorëzohet dekorata - çelësi i praruar në ari, i cili simbolizon portën e komunës.

3. Zbatimin e këtij vendimi do ta bëjë Kryetari i komunës, konform Rregullores për Dhënien e Dekoratave.

4. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë.

b). Shqyrtimi i Draft-marrëveshjes së binjakëzimit ndërmjet qytetit Norwalk (Iowa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe qytetit të Vushtrrisë (Republika e Kosovës).

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1. Me këtë vendim aprovet draft-marrëveshja e binjakëzimit ndërmjet qytetit Norwalk (Iowa, Shtetet e Bashkuara të Amerikës) dhe qytetit të Vushtrrisë (Republika e Kosovës).

2. Në kuadër të draft-marrëveshjes të cekur në pikën 1 të këtij vendimi, do të themelohet bashkëpunimi në fushat e përcaktuara në draft-marrëveshje mes të dy palëve.

3. Të dy palët zotohen se do të marrin përsipër obligimet që rrjedhin nga kjo draft-marrëveshje dhe do të angazhohen për jetësimin e bashkëpunimit në fushën e zhvillimit të qytetit, bashkëpunimit në fushën kulturore, bashkëpunimit në fushën ekonomike, si dhe në fushën e arsimit.

4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i Komunës, Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport, Drejtorja e Arsimit, si dhe Drejtorja për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural.

5. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryesuesi i Kuvendit i Komunës së Vushtrrisë.

c). Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtimin e shtëpisë për Valon Malokun

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – njoftoi se ka lidhur një marrëveshje me një fondacion nga shteti i Katarit, të cilët kanë shprehur gatishmëri që si bashkëdonatorë të përkrahin ndërtimin e disa shtëpive për personat me gjendje të rëndë socio-ekonomike, andaj në këtë kontekst kërkoi nga kuvendi që të përkrah propozim-vendimin në fjalë.

Pas shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - fondi për bashkëfinancim me donatorë për shoqatën “Qatar Charity” e cila është duke ia ndërtuar shtëpinë Valon Malokut me banim në fshatin Ropicë Komuna e Vushtrrisë, në shumën prej 1000 € (një mijë euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi ndahet me qëllim të ndërtimit të shtëpisë së Valon Malokut.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

ç). Shqyrtimi i Propozim- vendimit për ofrimin e ndihmës financiare për ndërtim e shtëpisë për Hamdi Hajdarin.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim lejohen mjete financiare nga buxheti i komunës - fondi për bashkëfinancim me donatorë për shoqatën “Qatar Charity” e cila është duke ia ndërtuar shtëpinë Hamdi Hajdarit me banim në Novolan-Vushtrri, në shumën prej 2000 € (dy mijë euro).

2.Shuma e cekur në nenin 1 të këtij vendimi, ndahet me qëllim të ndërtimit të shtëpisë së Hamdi Hajdarit.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale dhe Drejtoria për Buxhet dhe Financa.

d). Njoftimi i kryetarit të komunës lidhur me licencimin e zonës ekonomike në fshatin Lumadh.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – njoftoi kuvendin se Ministri i Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë ka nënshkruar vendimin për licencimin e zonës ekonomike në fshatin Lumadh. Tutje ai ceku se që nga dita e parë që ka marrë detyrën si kryetar i komunën, është angazhuar me tërë qenien e tij që ta realizojë atë që ka qenë edhe premtim kryesor elektoral, ndërtimi i zonës ekonomike në Lumadh. Pastaj shtoi se kur ka qenë në shqyrtim Ligji për Buxhetin në Kuvendin

e Kosovës ai së bashku me disa deputetë të Kuvendit të Kosovës ishte angazhuar dhe me iniciativën e tij ishte futur një amendament në Ligjin për Buxhetin për vitin 2018 ku është kërkuar financimi i zonës ekonomike si hapi i parë për realizimin e këtij projekti. Lidhur me këtë ai deklaroi se ndihet shumë i lumtur, pasi që deputetët e Kuvendit të Kosovës e kanë mbështetur të gjithë pa dallim partie dhe me këtë amendament janë siguruar 1.2 milion euro për zhvillimin e projektit zona ekonomike (Parku i Biznesit në Lumadh) dhe këto mjete janë ekstra nga buxheti i Kosovës dhe në esencë nuk e cenojnë kornizën financiare të komunës e cila është aprovuar me buxhetin e komunës për vitin 2018. Tutje, hapi tjetër që ka ndërmarrë komuna është marrja e pëlqimeve nga institucionet përkatëse ashtu siç e përcakton udhëzimi administrativ për licencim të zonave ekonomike, janë marrë të gjitha pëlqimet nga të gjitha ministrinë. Gjithsej 16 pëlqime është dashur të merren për licencimin e zonës ekonomike, në këtë kontekst ka pasur disa telashe në Ministrinë e Bujqësisë e cila ka bërë disa vonesa, por megjithatë edhe kjo çështje është zgjidhur, dhe Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përfundimisht në një afat shumë të shpejtë ka bërë licencimin e zonës ekonomike në fshatin Lumadh. Në vazhdim ai vlerësoi se lidhur me këtë projekt puna e madhe fillon tani pasi që duhet të bëhet rregullimi i krejt infrastrukturës për zonën ekonomike, por edhe vendosja e operatorëve ekonomikë në këtë zonë. Në këtë kontekst nënvizoi se në këtë zonë do të vendosen biznese të cilat gjenerojnë vende të reja të punës. Në relacion të zbutjes së nivelit të papunësisë në komunën tonë, njoftoi se ka zhvilluar bisedime me Ministrinë e Drejtësisë për atë si njihet vendi i quajtur “Kodra e Banjskës” ku atje do të angazhohemi për bërjen e një zone të madhe ekonomike, ku do të mund të vendosen edhe bizneset tjera të Komunës së Vushtrrisë që mund të transferohen atje. Në zonën ekonomike në fshatin Lumadh meqenëse kemi një sipërfaqe jo shumë të madhe prej 14 hektarëve do të vendosen vetëm bizneset që krijojnë vende të reja të punës dhe jo të kemi bartje të bizneseve ekzistuese. Lidhur me këtë sukses ai falënderoi të gjithë akterët që kanë qenë të involvuar në këtë proces, duke cekur se një ekip i profesionistëve kanë punuar në hartimin e studimit të fizibilitetit, kurse drejtoritë tjera me kohë i kanë kryer të gjitha procedurat për zhvillimin e këtij projekti dhe për këtë si kryetar i komunës ndihet mjaft mirë pasi që në 100 ditshin e qeverisjes së tij po arrin që ta jetësojë projektin zona ekonomike në Lumadh. Ajo çka vlerësoi si me rëndësi është fakti se tani çdo vendim për këtë projekt duhet të jetë i përbashkët i kryetarit të komunës dhe i kuvendit, në mënyrë që të mundësohet funksionalizimi i kësaj zone dhe t’i jepet përparësi zhvillimit ekonomik dhe vendeve të reja të punës. Ai u zotua se kjo do të ndodh dhe ceku se nga kjo pronë e komunës në sipërfaqe prej 14 hektarësh komuna deri më tani ka inkasuar mjete në vlerë prej 700 € në vit nga qiraja e tokës, kurse tani e tutje kjo pronë do të jetë në funksion të zhvillimit ekonomik dhe krijimit të vendeve të reja të punës.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – tha se zona ekonomike në fshatin Lumadh, është në qendër të programit për zhvillimin ekonomik të qeverisjes së re nga kryetari i komunës, andaj si LDK dhe si koalicion qeverisës e përgëzojnë kryetarin dhe qeverinë e tij për këtë sukses ndër më të madhin në 20 vitet e fundit për Komunën e Vushtrrisë. Pastaj ai propozoi që në fund të këtij diskutimi të nxjerret një vendim me dy pika, 1. Të gjitha procedurat që lidhen me funksionalizimin e zonës ekonomike duhet të udhëhiqen nga Komuna e Vushtrrisë dhe 2. Vendimin përfundimtar për vendosjen në zonën ekonomike duhet të merret nga komuna pasi që buxheti për zonën ekonomike është ndarë në mënyrë specifike nga kuvendi për zonën ekonomike në Lumadh dhe po ashtu Ligji për Dhënie në Shfrytëzim të Tokës Komunale përcakton se kjo e drejtë i takon komunës.

Ilmi Azemi, anëtar i kuvendit – në emër të grupit kuvendar të PDK-së ceku se e përkrahin këtë vendim, mirëpo në formën se si është propozuar nuk beson se është e qartë se për çka po vendoset. Tutje ceku se ky vendim është dashur të sjellët në mënyrë të shkruar për faktin se të votohet në mënyrë bllanko është e pakuptimt, por nëse veç jemi në procedura të rregullta atëherë ata do ta votojnë.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se për këtë çështje duhet ta jap mendimin Zyra ligjore, dhe shtoi se të gjithë beson se janë të interesuar që ta kenë një zonë ekonomike. Pastaj vlerësoi se kryetari i komunës arsyetoi deri tash 100 ditshin e qeverisjes dhe nuk dha ndonjë arsyetim për zonën ekonomike. Mandej ai kërkoi ta dijë se si është e mundur që prej 14 hektarëve pronë kemi pasur të hyra në vlerë prej 700 €. Në këtë kontekst ai ceku se me sa ai ka informacione ajo pronë i është dhënë në shfrytëzim një qytetari ku ai ka pasur obligim që t’i paguaj komunës 200€ për 1 hektarë. Andaj për këtë ceku se nëse kryetari i komunës vërteton që komunës i janë paguar vetëm 700 € në vit për këtë pronë, atëherë ai do të ndjek tjera procedura.

Abdullah Vojvoda, anëtar i kuvendit – tha se është fat i mirë që ky projekt për zonën ekonomike po bëhet realitet dhe atë fal njerëzve që kanë vullnet për zhvillim ekonomik të komunës si në komunë ashtu edhe në Ministrinë e Tregtisë dhe Industrisë për këtë ai tha se do të ketë mbështetje të plotë nga ana e tij.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – përsëriti se vendimi të cilin e propozoi ka dy pika dhe atë pika e parë të gjitha procedurat që lidhen me funksionalizimin e zonës ekonomike duhet të udhëhiqen nga Komuna e Vushtrrisë, ndërsa pika e dytë vendimi përfundimtar për vendosjen në zonë ekonomike duhet të merret nga komuna pasi që buxheti për zonën ekonomike është ndarë në mënyrë specifike nga kuvendi për zonën ekonomike në Lumadh.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se sa i përket kësaj pike të rendit të ditës në fillim të mbledhjes ajo u fut në rend të ditës si informatë dhe tani është mirë që Zyra ligjore dhe sekretaria e kuvendit të bëjnë interpretimin e Rregullores të punës së kuvendit, pasi që pas aprovimit të rendit të ditës ai nuk mund të ndryshohet dhe nuk mund të shtohen pika shtesë për futje në rend të ditës. Andaj vlerësoi se për një temë kaq me peshë siç është zona ekonomike, nuk duhet të votohet në këso forme, por që propozimi të vjen në mbledhjen e radhës ashtu që vendimet tona të jenë në suaza të rregullores dhe statutit të komunës.

Idriz Muzaqi, Udhëheqës i Zyrës Ligjore - tha se në rend të ditës ishte futur informatë lidhur me zonën ekonomike, dhe propozimi i anëtarit të kuvendit z.Feka ishte jashtë rendit të ditës. Pastaj ceku se ky projekt për zonë ekonomike është projekt trevjeçar dhe po të jetë e natyrës urgjente atëherë le të merret një pauzë dhe të gjendet një zgjidhje lidhur me këtë çështje, në të kundërtën nëse kjo çështje nuk është e natyrës urgjente, atëherë ajo do të mund të aprovohej në mbledhjen e radhës.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se kur është fjala për interes të përgjithshëm atëherë mund të shmangemi nga Rregullorja e punës e kuvendit dhe kjo në referim të dispozitave të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe duke votuar për atë propozim.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – tha se nga takimet që ka pasur me qytetarët nga të cilat ai graviton, ka marrë shqetësimin e tyre që operatorët ekonomikë që do të vendosen në zonën ekonomike t’i plotësojnë kriteret mjedisore, andaj gjatë vendosjes së këtyre kompanive duhet pasur kujdes që të respektohen kriteret mjedisore. Pastaj punëtorët që do të punësohen në këto kompani në kushte të barabarta përparësi t’u jepet banorëve të asaj zone.

Pas një konsulte të shëfave të grupeve kuvendare, si dhe duke u bazuar në nenin 47.2 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, kuvendi me vota unanime vendosi që të futë në rend të ditës Propozim – Vendimin lidhur me procedurat e funksionalizimit të Zonës ekonomike në fshatin Lumadh dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

dh). Shqyrtimi Propozim–vendimit lidhur me procedurat e funksionalizimit të Zonës ekonomike në fshatin Lumadh dhe përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë.

Qerim Selimi, anëtar i kuvendit – tha se është mirë që ky projekt po zhvillohet dhe shpresojmë se ai do të përfundojë sa më parë, projekt të cilit i gëzohemi të gjithë duke përfshi këtu edhe opozitën, për faktin se vlerësojmë se ky projekt për zonën ekonomike do të ndikojë

në zhvillimin ekonomik të komunës sonë dhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Shprehi përgëzime për të gjithë qytetarët për këtë projekt.

Fjolla Ujkani, anëtare e kuvendit – kërkoi sqarime nga kryetari i komunës se në çfarë baze do të vendosen bizneset në zonën ekonomike dhe kush do t'i përcaktojë se kush do të vendoset në atë zonë dhe propozoi që vendosja e bizneseve në zonën ekonomike të jetë në kompetencë të kuvendit të komunës pasi që kuvendi është organ përfaqësues i qytetarëve dhe në këtë formë do të kishte transparencë më të madhe sa i përket vendosjes së operatorëve ekonomikë në zonën ekonomike.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – sqaroi se në këtë fazë nuk po flitet për vendosjen e bizneseve në zonën ekonomike, por vetëm po përcaktohet sa a do të vendosë komuna apo dikush tjetër në këtë rast organet qendrore dhe tani po merret vendimi që të vendosë komuna, kurse më vonë do të vendoset se kush do të zhvillojë veprimtari ekonomike në atë zonë ekonomike.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit – kërkoi që propozimet e bëra nga anëtari i kuvendit z.Feka t'i ofrohen me shkrim në kopje fizike kuvendit.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se është mirë që anëtari i kuvendit z.Feka decidivisht ta propozojë vendimin pikë për pikë ashtu siç ai e ka menduar, duke u cekur që komuna do t'i marrë përsipër përgjegjësitë për caktimin e kritereve për vendosjen e operatorëve ekonomikë në zonën ekonomike, si dhe procedurat për dhënin në shfrytëzim. Në këtë formë do të mundësohet që t'u shmangemi komplikimeve dhe lajthitjes.

Shkëlzen Feka, anëtar i kuvendit – rikonfirmoi se vendimi të cilin e propozoi ka dy pika dhe atë pika e parë të gjitha procedurat që lidhen me funksionalizimin e zonës ekonomike duhet të udhëhiqen nga Komuna e Vushtrrisë (drejtoritë përkatëse), ndërsa pika e dytë vendimi përfundimtar për vendosjen në zonë ekonomike duhet të merret nga komuna pasi që buxheti për zonën ekonomike është ndarë në mënyrë specifike nga kuvendi për zonën ekonomike në Lumadh.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – pasi vlerësoi se qasja ironizuese e kryesuesit të kuvendit është e papranueshme, shtoi se edhe përkundër mendimit të Zyrës ligjore ai prapëseprapë qëndron prapa asaj se pas votimit të rendit të ditës nuk kemi të drejtë të fusim ndonjë pikë të re në rend dite për shqyrtim. Në të kundërtën nëse do të futej kjo pikë e rendit të ditës, atëherë nuk do të kishte kuptim që të mbaheshin mbledhjet urgjente dhe të jashtëzakonshme të kuvendit.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – duke iu referuar parafolësit ceku se pronat për të cilat po bëhet fjalë nga analizat e tokës të bërë në vitin 1985 është vlerësuar si tokë jopjellore e cila mund të cilësohet jashtë klasave të klasifikimit në bazë të ligjit për tokat, dhe Ministria e Bujqësisë e ka shpallur veten jokompetent për të lëshuar pëlqim dhe mund të vazhdohet me procedurat tjera të udhëhequra nga komuna, për shkak se është tokë jopjellore. Në fund ceku se ka një rast tjetër ku kemi dëmtim të pronës komunale dhe nga qeveria e kaluar nuk ishin ndërmarrë masa për zbatimin e vendimeve të kuvendit për mbrojtjen e asaj prone.

Nasuf Aliu, kryesues i kuvendit - tha se nëse dikush nga anëtarët e kuvendit mendon se ka ironizuar me të, atëherë ai kërkon falje publike, por shtoi se ironinë ndaj të tjerëve e urren shumë. Tutje vlerësoi se disa parafolës me diskutimet e tyre ishin tërësisht jashtë kontekstit të pikës së rendit të ditës. Në fund ai rilexoi se në nenin 47 i Ligjit për Vetëqeverisje Lokale thuhet se: gjatë mbledhjes së kuvendit mund të propozohet një pikë shtesë për t'u futur në rend të ditës për shqyrtim, andaj në këtë kontekst ceku se jemi brenda suazave ligjore.

Idriz Muzaqi, Udhëheqës i Zyrës Ligjore - tha se formulimi juridik i vendimit mund të na shkaktojë probleme në të ardhmen, për faktin se udhëheqja e procedurave nga ana e komunës në kohën kur mjetet janë në Ministrinë e Tregtisë do mund të shkaktoheshin probleme sa i përket zhvillimit të procedurave.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – tha se Ligji për Buxhetin, amendamenti që është aprovuar në Kuvendin e Kosovës thotë: për zonën ekonomike në fshatin Lumadh ndahet buxheti prej 1.2 milion euro. Ai buxhet i vendoset formalisht KIESA-së në Ministrinë e

Tregtisë dhe Industrisë, por i njëjti buxhet është i komunës dhe me një memorandum i kalohet komunës dhe vazhdohet procedura e udhëheqjes së procesit të funksionalizimit të zonës ekonomike. Tutje sqaroi se javën në vijim do të vjen ministri ku do zhvillohen biseda dhe të bëhet draft-marrëveshja ku në të do të mund të shkruhet se procedurat do të udhëhiqen nga ana e Ministrisë së Tregtisë për faktin se ata i kanë mjetet financiare, kurse ne do t'u themi jo, sepse ne kemi vendimin e kuvendit ku obligohemi që ne të zhvillojmë procedurat e funksionalizimit të zonës ekonomike. Andaj konform këtyre kërkoi nga kuvendi që kjo pikë të aprovohet me konsensus të plotë të të gjitha partive politike.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - tha se kur të jepet një propozim, atëherë duhet të jemi të sinqertë njëri me tjetrin, dhe të bëhet e qartë gjithçka. Mandej shtoi se tani e kuptoj se qëllimi final i këtij vendimi është që procedurat e prokurimit të udhëhiqen nga komuna dhe që buxheti të bartet në komunë, sepse procedurat tjera të dhënies në shfrytëzim do të udhëhiqen nga komuna për faktin se ajo pronë është në pronësi komunale. Në këtë rast nuk ka të keqe asgjë që këto procedura të udhëhiqen qoftë nga ministria qoftë nga komuna, por përsëriti se duhet të jemi të hapur dhe mos ta qesim në lajthim njëri tjetrin.

Xhafer Tahiri, Kryetar i Komunës – fillimisht ceku se askënd nuk po tenton ta qesë në lajthim dhe shtoi se me këtë vendim do ta fuqizojmë rolin e komunës në zhvillimin e projektit për zonën ekonomike. Pastaj gjatë negociimit të këtij projekti, kryetari i komunës do të zotohet para qeverisë që procedurat për këtë projekt do të udhëhiqen nga komuna për faktin se bëhet fjalë për pronën e komunës, se kemi lobuar për gjetjen e buxhetit për këtë projekt etj. Me këtë vendim do të formalizohet qëndrimi lidhur për këtë projekt, dhe ceku se nuk është i interesuar të udhëheqë procedura të prokurimit për asgjë, por është i interesuar që komuna të jetë vendimmarrëse dhe që mos të na ndodh që në tokën e komunës dikush tjetër të bëhet zot.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – tha se debati u orientua në drejtim jo të duhur dhe jo në pikën që ishte planifikuar në agjendë. Pastaj ceku se fillimisht u diskutua se a kemi të drejtë të fusim në rend të ditës një pikë shtesë dhe tani po debatohet për gjëra tjera, andaj kërkoi që të ndiqen procedurat që kjo pikë të aprovohet.

Në fund të debatit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës kuvendi pas votimit me 31 vota “për” 3 “abstenime” vendosi me sa vijon:

1.Me këtë vendim vendoset që të gjitha procedurat lidhur me funksionalizimin e Zonës ekonomike në fshatin Lumadh të udhëhiqen nga Komuna e Vushtrrisë, (drejtoritë kompetente komunale).

2.Vendimi përfundimtar për përzgjedhjen e operatorëve ekonomikë në zonën ekonomike (parku i biznesit në fshatin Lumadh), do të merret konform nenit 11 paragrafi 2, të Ligjit Nr.04/L-159 për Zonat Ekonomike nga themeluesi – Komuna e Vushtrrisë.

3.Për zbatimin e këtij vendimi obligohen: Kryetari i komunës, Drejtoria për Ekonomi, Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, si dhe Drejtoria e Prokurimit.

4. Ky vendim hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas regjistrimit në Zyrën e Protokollit të Ministrisë për Administrimin e Pushtetit Lokal, si dhe shtatë (7) ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës së Vushtrrisë.

e). Shqyrtimi i raportit lidhur me implementimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

Lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë “unanime” aprovoi raportin lidhur me implementimin e Planit për menaxhimin e mbeturinave në Komunën e Vushtrrisë.

ë). Pyetjet e anëtarëve të kuvendit:

Habibe Gërxhaliu, anëtare e kuvendit – tha se këtë vit është gjenerata e fundit e studentëve që kanë përjetuar luftën, të cilët janë pasardhës të kategorive të dala nga lufta, andaj kërkoi nga komisioni për ndarjen e bursave që të merr për bazë këtë kategori gjatë vendosjes për ndarjen e bursave.

Mejreme Ismajli, anëtare e kuvendit – kërkoi që të intervenohet në rregullimin e kanalizimit në shkollën e fshatit Pantinë, pasi aty ujërat e zeza kanë vërshuar dhe kemi rrezik për përhapjen e ndonjë epidemie. Gjithashtu kërkoi që kanalizimi të ndërtohet edhe në lagjen Pllana, pasi që aty është duke u shkatërruar rruga për shkak të ujërave të zeza.

Lutfi Bilalli, anëtar i kuvendit – kërkoi që t’u dilet në ndihmë dy talenteve nxënëse të shkollës së mesme Gjimnazi “Eqrem Çabej”, të cilat do të marrin pjesë në olimpiadën ndërkombëtare të diturisë në SHBA, ku për këtë rast kërkesë ka parashtruar edhe drejtori i shkollës përkatëse.

Faton Shabani, anëtar i kuvendit – pasi përgëzoi kryetarin e komunës për marrjen e vendimit për lirim të hapësirave publike, pyeti se çka nënkupton trajtimi i veçantë i ankesave.

Nezir Klinaku, anëtar i kuvendit – tha se është mirë që disa prona po shpallen zona me interes të përgjithshëm, por komuna duhet ta ketë një plan ideor se çka do të ndërtojë në ato zona. Në fund duke iu referuar një personi (i cili i ka përfunduar studimet në drejtimin adekuat), i cili kërkon të punësohet i është thënë nga ana e një drejtori të drejtorisë komunale në Komunën e Vushtrrisë, citojmë: “do të kishim pranuar në punë por facebook yt është i mbushur me shkrime për subjektin politik Lëvizja për Bashkim”, andaj kërkoi në këtë rast të jeni të kujdesshëm përndryshe do t’i denoncojë tek autoritetet kompetente. Në këtë kontekst ai vlerësoi se një gjë e tillë është e papranueshme dhe ceku se imagjini se si mund të ndihet një njeri kur nga ana e qeverisë komunale i thuhet një gjë e tillë.

Afrim Namani, drejtor i DA-së - lidhur me rregullimin e kanalizimit në shkollën e fshatit Pantinë, njoftoi se ai e ka këtë informacion dhe se ka kontaktuar me punëkryerësin i cili e ka shkaktuar këtë dëm që i njëjti do ta rregulloj, andaj ky i fundit është zotuar se do të sanojnë këtë problem. Lidhur me kërkesën e z.Bilalli për ofrimin e ndihmës për dy nxënëset e gjimnazit njoftoi se dje ka nënshkruar propozimet për ofrimin e ndihmës për këto nxënëse, dhe pritet që kryetari i komunës t’i nënshkruajë vendimet për ofrimin e ndihmës për këto nxënëse. Në këtë kontekst njoftoi se ka pasur shumë interpretime e madje edhe shpesh dezinformim të opinionit për këtë kërkesë. Sa i përket deklarimeve të anëtarit të kuvendit z.Klinaku, ai u shpreh se vërtet nuk ndihet mirë për faktin se në drejtorinë të cilën ai e drejton ka më së tepërmi konkurse dhe ceku se ai kishte me pas dëshirë që emri i atij drejtori të bëhet publik.

Sedat Rashica, drejtor i DSHP - njoftoi se tani drejtorja gjendet para nënshkrimit të kontratës për furnizim me gypa dhe sqaroi se në të ardhmen kanë vendosur që nuk do të lejojnë që furnizimi me gypa të bëhet në distanca të gjata për faktin se më vonë po dalin shumë probleme. Gjithashtu lidhur me këtë problematikë ai njoftoi se për çdo furnizim me gypa për qytetarët do të jepet një pëlqim ku do të jepet afati brenda të cilit duhet të përfundohet vendosja e këtyre gypave dhe mënyra e vendosjes do të mbikëqyret.

Sami Istrefi, anëtar i kuvendit - kërkoi që të kemi një mobilizim dhe t’i dilet në ndihmë Drejtorisë së Arsimit, ku do të rishikoheshin rregulloret e arsimit, ku do të bëhej e mundur

funksionalizimi i trupave të shkollave atje ku operojnë. Pastaj kërkoi që të mbyllen dyert e shkollës së mesme e ulët afër stacionit të policisë, për faktin se ekziston dyshimi që nxënësit që po dalin jashtë oborrit të shkollës po përdorin substanca narkotike. Në fund ai kërkoi që në një rën nga mbledhjet e ardhshme të formohet një trup nga ana e kuvendit e cila do merrej me rishikimin e rregulloreve në fushën e arsimit në komunën tonë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e tij se operatori ekonomik i cili është duke punuar në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit është duke i dëmtuar rrugët dhe bizneset në fshatin Stanoc. Ai ka kërkuar që këto rrugë të kthehen në gjendjen e mëparshme. Pastaj është dëmtuar rrethoja e varrezave të fshatit dhe as kjo nuk është rregulluar. Mandej gjendja higjieniko-sanitare në shkollën fillore “Migjeni” nuk është e mirë dhe kërkoi që të ndërmerren masa. Po ashtu sa i përket furnizimit me gypa të kanalizimit njoftoi se në fshatin Stanoc i Epërm në tri lagje, tri familje posedojnë gypa të kanalizimit. Në lagjen “Ajvazi” një familje i ka më tepër se 1000m gyp të kanalizimit, ndërsa komplet lagjja nuk ka rrjet të kanalizimit të rregulluar. Familja tjetër në lagjen “Haradinaj-Bregaj” komplet lagjja i kanë gypat Fi-160 në gjatësi prej 600 m, kurse kanalizimi nuk është i vendosur fare në këtë lagje, ndërsa lagjja “Prronaj” është e ndarë në dy lagje dhe komplet lagjja e ka gypin e kanalizimit deri tek përrocka, kurse nevojiten edhe 20 m gyp të kanalizimit për kyçje në linjën kryesore të kanalizimit dhe për këtë ujërat e zeza derdhen në përrockë. Lagja tjetër “Prronaj” gjithashtu i ka gypat e kanalizimit në gjatësi prej 500 m, por kanalizimi nuk është i rregulluar. Lidhur me këtë ai vlerësoi se këta gypa a janë shpërndarë në fushatë zgjedhore nga ish partia në pushtet dhe me çfarë kriteri janë shpërndarë ata gypa. Pastaj edhe në lagjen “Haradinaj” kemi bllokim të kanalizimit dhe për këto kërkoi nga drejtorja përgjegjëse që t’i ndërmarrë veprimet dhe masat e nevojshme.

Mbledhja përfundoi në ora 13:55.

Bastri Duraku

Nasuf Aliu

Procesmbajtës

Kryesues i Kuvendit

funksionalizimi i trupave të shkollave atje ku operojnë. Pastaj kërkoi që të mbyllen dyert e shkollës së mesme e ulët afër stacionit të policisë, për faktin se ekziston dyshimi që nxënësit që po dalin jashtë oborrit të shkollës po përdorin substanca narkotike. Në fund ai kërkoi që në një rën nga mbledhjet e ardhshme të formohet një trup nga ana e kuvendit e cila do merrej me rishikimin e rregulloreve në fushën e arsimit në komunën tonë.

Ymer Haradinaj, anëtar i kuvendit – ngriti shqetësimin e tij se operatori ekonomik i cili është duke punuar në shtrirjen e rrjetit të ujësjellësit është duke i dëmtuar rrugët dhe bizneset në fshatin Stanoc. Ai ka kërkuar që këto rrugë të kthehen në gjendjen e mëparshme. Pastaj është dëmtuar rrethoja e varrezave të fshatit dhe as kjo nuk është rregulluar. Mandej gjendja higjieniko-sanitare në shkollën fillore “Migjeni” nuk është e mirë dhe kërkoi që të ndërmerren masa. Po ashtu sa i përket furnizimit me gypa të kanalizimit njoftoi se në fshatin Stanoc i Epërm në tri lagje, tri familje posedojnë gypa të kanalizimit. Në lagjen “Ajvazi” një familje i ka më tepër se 1000m gyp të kanalizimit, ndërsa komplet lagjia nuk ka rrjet të kanalizimit të rregulluar. Familja tjetër në lagjen “Haradinaj-Bregaj” komplet lagjia i kanë gypat Fi-160 në gjatësi prej 600 m, kurse kanalizimi nuk është i vendosur fare në këtë lagje, ndërsa lagjia “Prronaj” është e ndarë në dy lagje dhe komplet lagjia e ka gypin e kanalizimit deri tek përrocka, kurse nevojiten edhe 20 m gyp të kanalizimit për kyçje në linjën kryesore të kanalizimit dhe për këtë ujërat e zeza derdhen në përrockë. Lagja tjetër “Prronaj” gjithashtu i ka gypat e kanalizimit në gjatësi prej 500 m, por kanalizimi nuk është i rregulluar. Lidhur me këtë ai vlerësoi se këta gypa a janë shpërndarë në fushatë zgjedhore nga ish partia në pushtet dhe me çfarë kriteri janë shpërndarë ata gypa. Pastaj edhe në lagjen “Haradinaj” kemi bllokim të kanalizimit dhe për këto kërkoi nga drejtoria përgjegjëse që t’i ndërmarrë veprimet dhe masat e nevojshme.

Mbledhja përfundoi në ora 13:55.

Bastri Duraku



Procesmbajtës

Nasuf Aliu



Kryesues i Kuvendit

